



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA
GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS MALISHEVË

C.nr.47/21

Gjykata Themelore Gjakovë-Dega e Gjykatës në Malishevë, Departamenti i Përgjithshëm/ Divizioni Civil, gjyqtari Petrit Curri në çështjen juridike kontestimore të paditësit L.Th. nga fshati Sh.-Komuna e M., të cilin me autorizim e përfaqëson Agron Kryeziu avokat nga Malisheva, kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve “Eurosig” me adresë Bulevardi “Dëshmorët e Kombit” në Prishtinë, me objekt kontesti: ”Kompensim i dëmit material dhe jo-material”, vlera e kontestit 500.00 euro, jashtë seancës gjyqësore me datë 23.05.2024 mori këtë:

A K T V E N D I M

KONSTATOHET se paditësi L.Th. nga fshati Sh.-Komuna e M., **e ka tërhequr padinë** që identifikohet në këtë gjykatë me shenjë C.nr.47/2021 të datës 16.02.2021, kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve “Eurosig” me seli në Prishtinë.

A r s y e t i m

Paditësi L.Th. nga fshati Sh.-Komuna e M., përmes të autorizuarit të tij Agron Kryeziu avokat në Malishevë, me datë 16.02.2021 në këtë gjykatë ka ushtruar padi kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve “Eurosig” me seli në Prishtinë, me objekt kontesti: “Kompensim i dëmit material dhe jo-material”, vlera e kontestit 500.00 euro.

Lidhur me këtë, gjykata me datë 22.03.2024 ka nxjerrë aktvendim për përgjigje në padi dhe të njëjtin ia ka dërguar të paditurës, e cila me datë 17.04.2024 ka kthyer përgjigje duke theksuar se ka arritur marrëveshje jashtë gjyqësore me paditësin dhe ka propozuar që të hedhet padia.

Përfaqësuesi i paditësit, me datë 19.04.2024 e ka dorëzuar në këtë gjykatë parashtrësën për tërheqjen e padisë në këtë çështje juridiko-kontestimore, duke e njoftuar gjykatën se me të paditurën Kompaninë e Sigurimeve “Eurosig” me seli në Prishtinë, kanë lidhur marrëveshje jashtëgjyqësore për kompensimin e dëmit, andaj ka kërkuar tërheqjen e padisë së parashtruar pranë kësaj gjykate.

Gjykata vlerëson se konform nenit 3 par.1 të LPK-së, i cili i referohet parimit të disponibilitetit, palët mund të disponojnë lirisht me kërkesat e parashtruara në procedurë kontestimore, përfshirë edhe tërheqjen e padisë, veprim ky i përcaktuar me dispozitën nga neni 261 par.2 të LPK-së, ku parashihet se: *“Padia mund të tërhiqet edhe më vonë, deri në përfundimin e shqyrtimit kryesor, në qoftë se i padituri e jep pëlqimin për një gjë të tillë. Po që se i padituri brenda shtatë (7) ditësh nga dita e njoftimit për tërheqjen e padisë nuk deklarohet për këtë gjë, do të konsiderohet se e ka dhënë pëlqimin për tërheqjen e padisë”*.

Bazuar në faktin se paditësi e ka tërhequr padinë pasi i padituri ka paraqitur përgjigje në padi, atëherë gjykata vlerëson se janë përmbushur prezumimet procedurale për të vepruar konform dispozitës nga neni 261 par.3 të LPK-së, e cila përcakton se: *“Po që se padia është tërhequr, gjykata jep aktvendim me të cilin konstatohet se është tërhequr padia. Ky aktvendim i dërgohet të paditurit vetëm po që se padia i është dorëzuar me parë”*.

Andaj, në një gjendje të këtillë, Gjykata në kuptim të dispozitave nga neni 261 par. 2 dhe 3 lidhur me nenin 387.1 pika c, të Ligjit për Procedurën Kontestimore, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Gjykata Themelore Gjakovë-Dega e Gjykatës në Malishevë
Departamenti i Përgjithshëm/Divizioni Civil
C.nr.47/2021, datë 23.05.2024

G j y q t a r i
Petrit Curri

Udhëzim juridik: *Kundër këtij Aktvendimi, nuk është e lejuar ankesa konform nenit 261 par. 4 të LPK-së.*